

## MISIONI NDËRKOMBËTAR I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

### Deklarate E Informacioneve Dhe Perfundimeve Paraprake

**Tiranë, më 14 Tetor 2003** - Misioni Ndërkombëtar i Vëzhgimit të Zgjedhjeve (MNVZ) për zgjedhjet e pushtetit vendor më 12 Tetor 2003, në Republikën e Shqipërisë është një perpjekje e perbashket e Zyrës së Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dhe me Këshillin e Kongresit European të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale. (KEAVR).

### PËRFUNDIME PARAPRAKE

Zgjedhjet e 12 Tetorit për organet e qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë shënuan një progres të mëtjshëm në përputhje me standartet dhe angazhimet e OSBE-së, Këshillit të Europës dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë për zgjedhjet demokratike. Megjithate, mbeten për t'u trajtuar një sërë mangësish përpara zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, veçanërisht në lidhje me listën e votuesve, që vazhdoi të mbetet problematike.

Zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis të përmirësuar politik, duke ndjekur konsensusin midis qeverise dhe opozites ne trajtimin e rekomandimeve te Raportit Perfundimtar te OSBE/ODIHR mbi zgjedhjet parlamentare 2001.

Karakteristikat që ndihmuan në këtë vlerësim pozitiv përfshijnë:

- Zgjedhjet u zhvilluan sipas Kodit të ri Zgjedhor, i cili i u adresohet një varg shqetësimesh, që dolën nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, veçanërisht lidhur me procedurat e ankimimit dhe apelimit;
- Presidenti, qeveria dhe udhëheqësit e partive politike dhanë ndihmesën e tyre për një mjedis të përmirësuar politik;
- Fushata zgjedhore u zhvillua në një atmosferë të qetë, partitë politike e kanë trajtuar njëra tjetren si kundërshtarë legjitim dhe pa retorikën e nxehtë që demtonte fushatat e kaluara;
- Transmetuesit kryesorë duke përfshirë TVSH, u janë përbajtur dispozitave ligjore për raportim të barazpeshuar duke kontribuar në një përmirësim të ndjeshëm në pasqyrimin e fushatës;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) i ka administruar zgjedhjet, përgjithësisht, në mënyrë profesionale, transparente, madje edhe objektive, pavarësisht nga kundërshtimet e fuqishme për mungesën e presupozuar të barazpeshës politike;
- Policia i është përbajtur udhëzimeve për të qëndruar larg qendrave të votimit ditën e zgjedhjeve duke përmirësuar atmosferën zgjedhore.
- Vëzhgimi nga monitoruesit vendas ka qenë më i plotë krahasuar me zgjedhjet e mëparshme; dhe
- Kolegji Zgjedhor ka marrë vendime, në kohë dhe me efikasitet, mbi ankimimet dhe apelimet.

Disa mangësi të vërejtura gjatë procesit përfshijnë:

- Korniza ligjore përmban disa dispozita problematike, që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionimin e komisioneve zgjedhore dhe ka mungesë qartësie për disa çështje të tjera;

- Mungesa e rregullave efikase të procedurës së KQZ sollën vonesa në miratimin e vendimeve dhe udhëzimeve të rëndësishme, shpërndarjen me vonesë të materialeve të zgjedhjeve dhe shtyrjen e trajnimit për anëtarët e komisioneve të nivelit të tretë;
- Anëtarët e Komisioneve Zgjedhore të Qeverisjes Vendore (KZQV) dhe Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV), në përgjithësi kanë patur njohuri të pakta të Kodit të ri Zgjedhor dhe të udhëzimeve kryesore të KQZ-së;
- Nje vonese në lëvrimin e fondeve publike për fushatat politike krijoi përparësi për kandidatët, aktualisht në detyrë, si dhe atyre që zotëronin burime private;
- Rishikimi jokohorent i listës përfundimtare të votuesve nga KZQV-të dhe Gjykatat e Rretheve, përfshire dhe amendamentet nga KQZ, te kryera deri në prag të zgjedhjeve, solli pasiguri dhe konfuzion në ditën e zgjedhjeve;
- Kutitë e Votimit ishin shumë të vogla për përmasat e fletëve të votimit, si pasoje kerkohej dërgimi i kutive të tjera dhe zgjatja e orarit të votimit me një orë në Tiranë;
- Partitë politike dhe kandidatët ngurrnin të përdornin mekanizmat për ankimim dhe apelim në Kodin e ri Zgjedhor;
- Tendenca e uljes së përfaqësimit të femrave, si kandidate, ka vazhduar, perfaqesimi I femres si anetare e komisioneve zgjedhore ka qene mjaft I ulet. Votimi i nje anetari per të gjithë familjen është vëzhguar në mbi 30% të qendrave të votimit të vizituara nga vëzhguesit.

Dita e zgjedhjeve ishte përgjithësisht e qetë, me një pjesëmarrje prej 52% të votuesve të regjistruar. Proçesi i votimit u zhvillua kryesisht, sipas procedurave të vendosura, por janë vërejtur parregullsi vecanerisht në lidhje me mospërdorimin e rregullt të bojës për të parandaluar votimin dy here. Ka patur shumë raportime për probleme me listat e votuesve si dhe votues që ktheheshin mbrapsht nga komisioneret në qendrat e votimit. Në Himare kanë ndodhur incidente të dhunshme. Numërimi i votave është vlerësuar negativisht në një numër të madh qendrash votimi.

Vlerësimi përfundimtar i këtyre zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga përfundimi i numërimit dhe përpilimi statistikor i rezultateve, shpallja përfundimtare e rezultateve paraprake dhe finale nga KQZ, si dhe proçesi i ankimimeve dhe apelimeve.

Arritjet e zgjedhjeve vendore 2003 kanë ardhur si rezultat i vullnetit politik nga të dy krahët e spektrit politik për trajtimin e çështjeve të ngritura nga zgjedhjet e mëparshme. OSBE dhe Këshilli i Europës janë të gatshëm të asistojnë autoritetet dhe shoqërinë civile të Republikës së Shqipërisë për të vazhduar në përmirësimin e proçesit zgjedhor. Në këtë këndvështrim, është e rëndësishme që puna të fillojë pa vonesë me adresimin e mangësive të identifikuara në këto zgjedhje dhe në aspektet e mbetura të Kodit Zgjedhor, që kërkojnë përmirësime të mëtejshme në kohë para zgjedhjeve të ardhshme parlamentare.

---

## INFORMACIONE PARAPRAKE

---

### Historik

Zgjedhjet për organet e pushtetit vendor 2003, ishin zgjedhjet e katërta të zhvilluara në Shqipëri, që nga vendosja e pluralizmit në vitin 1991. Zgjedhjet u zhvilluan për anëtarë të këshillave dhe kryetarë bashkie në 65 bashki, 308 komuna dhe 11 njësi bashkiake të Tiranës.

Zgjedhjet u zhvilluan në një mjedis politik me përmirësime të konsiderueshme, që prej zgjedhjeve të qeverisjes vendore në vitin 2000 dhe ato parlamentare në vitin 2001. Një periudhë gjashtë mujore konsensusi mes Partisë Socialiste (PS) në pushtet dhe Partisë Demokratike në opozitë, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2002, ndihmoi në krijimin e një dinamike pozitive në politikën shqiptare dhe

hapi rrugë komunikimi në disa nivele të strukturave partiake. Domethënëse në këtë periudhë është zgjedhja konsensuale e Presidentit të Republikës. Komisioni parlamentar bipartizan, i ngritur për të trajtuar shqetësimet e dala nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2001, u mblodh për një vit. Deri në Prill 2003 komisioni trajtoi me sukses shumicën e rekomandimeve të përfshira ne Raportin Përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2001.

Në zgjedhjet e fundit u vërejt një përparim në zhvillimin e fushatës, media dhe administratën zgjedhore, por mbeten problematike, veçanërisht ne mungesën e ndryshimeve efektive ligjore. Për rrjedhojë nga të gjitha partitë politike u kuptua gjerësisht se një përmirësim i dukshëm në zhvillimin e këtyre zgjedhjeve do të kishte ndikim shumë të madh në Proçesin e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin European, që ka nisur në 31 Janar 2003.

### **Korniza Ligjore**

Zgjedhjet u zhvilluan sipas Kodit te ri Zgjedhor të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në 19 Qershor 2003 mbi bazat e amendamenteve të pranuar me konsensus nga komisioni bipartizan dhe dy marrveshje protokollare midis PS e PD. Komisioni bi-partizan pati asistencen e Prezences se OSBE-se ne Shqiperi, OSBE/ ODIHR dhe Keshillit te Europes. Si PS ashtu edhe PD e kanë mbështetur publikisht Kodin e ri, duke i dhënë fund një periudhe shtatëvjeçare kontestimi të legjislacionit zgjedhor.

Mbi të gjitha, Kodi i ri Zgjedhor ka përmirësuar ndjeshëm kornizën ligjore të zgjedhjeve dhe i është adresuar pjesës më të madhe të rekomandimeve në Raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet parlamentare të vitit 2001. Një përmirësim kyç lidhet me procedurat e thjeshtëzuara dhe më transparente për ankimimet dhe apelimet kundër vendimeve të komisioneve zgjedhore.

Gjithsesi, Kodi përmban një numër papajtueshmëri afateve kohore joreale si dhe detaje te pamjaftueshme mbi nje varg ceshtjesh, si bërja publike e financave të partive politike dhe kanidatëve, siç është vërejtur në protokollin e dytë PS-PD. Një fushë tjetër kryesore që përbën shqetësim është përbërja dhe vendim-marrja në komisione zgjedhore të ndryshme. Kjo I mundesoi partitë politike te bllokoni efektivisht vendim-marrjen në komisione zgjedhore të të gjitha niveleve.

Në 01 Tetor, Këshilli I Ministrave nxori një akt normativ, amendoi ligjin për Policinë e Shtetit, duke zgjeruar grupin e forcave të policisë, që do të përdroreshin gjatë periudhës së ditës së zgjedhjeve. PD e kundërshtoi fuqimisht natyrën e njëanshme të veprimit të qeverisë. KQZ më vonë nxori një Udhëzim duke theksuar se policia do të lejohej në dhe rreth qendrës së votimit, vetëm me kërkesë të shkruar qartë nga kryetari dhe nënkryetari i KQV-së. Ky vendim u miratua me votë unanime.

### **Administrata Zgjedhore**

Zgjedhjet u administruan nga një administratë zgjedhore me tri nivele: KQZ; 384 KZQV, në çdo bashki e komunë; dhe 4, 688 KQV, në çdo qendër votimi.

KQZ i administroi zgjedhjet, përgjithësisht, në mënyrë profesionale, transparente dhe objektive. Përbërja e KQZ ishte një çështje debati gjatë gjithë fushatës zgjedhore, me akuzat e opozitës për mungesë të barazpeshës politike, por kjo nuk i pengoi anëtarët për përmbushjen e detyrave të tyre. Anëtarët e KQZ u mbështetën nga një Sekretariatat i pavarur dhe përgjithësisht kompetent,

megjithëse kishte mungesë të planifikimit në kohë të fazave kyçe në administratën e zgjedhjeve, veçanërisht në shpërndarjen e materialeve.

Ndërhyrje të shumta nga përfaqësues të partive politike pa të drejtë vote në sesionet e KQZ-së, ndikuan negativisht në proces dhe shaktuan vonesa serioze në miratimin e udhëzimeve të rëndësishme. Shumë afate kohore u shtynë për çështje të rëndësishme, të cilat kërkonin një vendim nga KQZ, duke përfshirë rregjistrimin e kandidatëve, rishikimin e listave paraprake, vendndodhjen e qendrave të votimit, dhe procedurat për numërimin. KQZ nuk arriti të miratojë amendamente për rregullat e procedurës, të cilat do të ndihmonin në përshejtin e punës së tij, duke i dhënë mundësi Kryetarit të kufizonte debatin.

Pavarësisht nga vështirësitë e fillimit për caktimin e sekretarëve, KZQV-të në përgjithësi funksionuan në mënyrë kolegjiale dhe efektive. Megjithatë, me afrimin e ditës së zgjedhjeve, disa KZQV pushuan së funksionuari për shkak të mosmarrveshjeve midis anëtarëve. KQZ nuk ndërhyri në këto mosmarrveshje, duke e lënë trajtimin e tyre në dorë të partive politike. Në përgjithësi, KZQV-të vepruan në mënyrë pasive dhe nuk arritën t'u përmbahen afateve kohore të kërkuara nga Kodi Zgjedhor për rishikimin e listave paraprake të votuesve dhe vendndodhjen e qendrave të votimit. Anëtarët e KQV-ve u caktuan në shumicën e rasteve me vonese nga partitë politike. KZQV-të shpesh shmangnin edhe marrjen e vendimeve për ankesat që u adresoheshin atyre, duke i kaluar ato në KQZ pa marrë një vendim zyrtar.

Shumë anëtarë të KZQV-ve shfaqën njohuri të kufizuara të kodit të ri zgjedhor, pavarësisht nga trajnimi që kanë marrë. Caktimi me vonesë dhe trajnimi i shumë anëtarëve të KQV-ve si dhe shpërndarja me vonesë e udhëzimeve nga KQZ, shkaktoi një mungesë njohurie në shkallë të gjerë për procedurat në ditën e zgjedhjeve. Kjo u shoqërua me zëvendësimin e shume anëtarëve të KQV-ve në prag të zgjedhjeve. Edhe pse u shty për shkak të printimit me vonesë të materialeve, trajnimi i anëtarëve të KQV-ve, siguruar nga KQZ në bashkëpunim me IFES (Fondacini Ndërkombëtar për Sistemin e Zgjedhjeve), ishte përgjithësisht i mirë, pavarësisht nga pjesëmarrja e ulët në disa zona.

Ankesat për procesin e rishikimit të listës së votuesve u vërejtën gjerësisht. Me qëllim përmbushjen e kërkesave të partive politike, KQZ shtyu afatet kohore për procesin e rishikimit dhe udhëzoi KZQV-të të bënin përpjekje shtesë për të kontrolluar emrat e votuesve edhe kur KZQV-ve nuk u paraqiteshin evidenca vertetuese. Megjithëse partitë politike i paraqitën ankesat pranë OSCE/ODIHR dhe KQZ për vendimet e KZQV-ve për listat paraprake, shumë pak prej tyre i çuan ato në gjykatat e rrethit siç e përcakton edhe kodi zgjedhor. Për rrjedhojë, u vonua publikimi i listës përfundimtare të votuesve. Edhe pas daljes së listës, dhe me kërkesë të partive politike, KQZ bëri hetime dhe ndryshime të mëtejshme në listën përfundimtare të votuesve, duke shkaktuar një vonesë në shpërndarjen e tyre si dhe shtuar më tej paqartësinë e përgjithshme për saktësinë e tyre. Në total në listën përfundimtare u përfshinë 2,703,608 votues.

## **Fushata Zgjedhore**

Rreth 1,750 kandidatë u regjistruan për të marrë pjesë në garën për kryetar bashkie dhe pothuaj 4,000 lista të veçanta u paraqitën nga partitë dhe kandidatë të pavarur për zgjedhjen e këshilltarëve.

Fushata u zhvillua në një atmosferë të rregullt e të qetë me një reduktim të retorikës së nxehtë që dëmtonte fushatat e kaluara me vetëm pak raportime të izoluara për tentativë shantazhi me presion për humbje të vendit të punës. Debati u bë më i dukshëm se në zgjedhjet e mëparshme. Ndërkohë që gara për bashkinë e Tiranës ka zënë pjesën më të madhe të vëmendjes, fokusi i fushatës shpesh ishte

në platformën kombëtare të partisë. Veprimtaritë dhe materialet e fushatës kishin pjesëmarrjen e udhëheqësve të partive ndaj kandidatëve shpesh u duhej t'u lëshonin terren në pasqyrimin mediatik, deri në javën e fundit, kur kandidateve iu kushtua më shumë vëmendje. Në nivel vendor, sfidantët pretendonin për korrupsion të kandidatëve që ishin aktualisht në detyrë.

Si rrjedhojë e vonesës nga qeveria, fondet publike për fushatën u lëvruan për partitë politike vetëm gjatë javës së tretë të fushatës dhe shumë degë lokale paraqesin pretendime se nuk kanë marrë asnjë fond. Për pasojë, partitë në pushtet dhe kandidatët me fonde private patën një avantazh të ndjeshëm karshi kandidatëve të tjerë. Partitë e vogla të opozitës pretenduan se vonesa ishte e qëllimshme dhe se kufizonte mundësitë e tyre për të bërë fushatë. Disa kandidatë, shumë prej të cilëve biznesmenë, e financuan fushatën me fondet e tyre.

Janë marrë ankesa të shumta se kandidatët në detyrë përdorin pozitën që kanë për përfitime të fushatës së tyre. Përveç kësaj, partitë e opozitës pretendojnë se PS shfrytëzoi në maksimum kontrollin mbi qeverisjen qendrore për të promovuar fushatat e kandidatëve të vete vendorë. Vëzhguesit OSBE/ODIHR raportojnë disa incidente ku kandidatët që janë aktualisht në detyrë, duket se përfitojnë nga avantazhet e pozicionit zyrtar që kanë.

## Media

Nje spekter i gjere i medias elektronike dhe te shkruar u siguroi votuesve nje informacion te zgjeruar rreth fushatave te partive politike dhe kandidateve te tyre, si dhe aktiviteteteve te administrates elektorale. Mbulimi mediatik kryesisht u perqendrua ne aktivitetet e Partise Socialiste dhe Demokratike.

Mbulimi televiziv, ne nje zhvillim vleresues, u permiresua dukshem ne krahasim me zgjedhjet e meparshme. Pothuajse te gjithe transmetuesit mediatik te monitoruar nga OSBE/ODIHR kane vepruar ne perputhje me detyrimet e tyre ligjore per te dhene mbulim te balancuar dhe korrekt te partive dhe kandidateve kryesor. Pergjithesisht, toni pasqyrues i mediave elektronike nuk ka qene as agresiv, as emocional. Te gjitha stacionet televizive te monitoruara nga OSBE/ODIHR i kane pasqyruar partite politike dhe kandidatet me tone positive dhe neutrale. Si TV kombetare ashtu dhe ato locale kane organizuar debate midis partive dhe kandidateve. Megjithate, OSBE/ODIHR ka verifikuar ankesat e partive te vogla se ne debatet e zhvilluara ne televizionet kombetare jane perfshire vetem perfaqesues nga PS dhe PD.

Ne perputhje me detyrimet e veta si transmetues i sherbimit publik, TVSH caktoi 24% te lajmeve kryesore dhe programeve informative per PD, 22% per SP, 20% per qeverine dhe kohen e mbetur 34% per partite e tjera politike. Koha falas e transmetimit eshte ndare sipas rregullave te percaktuara ne Kodin Elektoral. PS dhe PD moren perkatesisht nga nje ore transmetim, ndersa partite e tjera parlamentare me me pak se 20% vend ne parlament moren 30 minuta secila. Dy stacione televizive private te monitoruara nga OSBE/ODIHR, TV Klan dhe TV Arberia caktuan pergjithesisht mbulim te balancuar.

Mbulimi elektoral ne median e shkruar ishte me agresiv dhe negativ ne krahasim me median elektronike. Megjithate, mbulimi ishte me i moderuar ne krahasim me zgjedhjet e kaluara dhe nje hapesire me e gjere u siguroi per pasqyrimin e opinioneneve dhe kendveshtrimeve te ndryshme. Mbulimi mediatik shpesh drejtohej ndaj polemikave dhe lajmeve sensacionale. Sipas gazetave te monitoruara nga OSBE/ODIHR, PS ka marre 34% te hapesires se caktuar per zgjedhjet, PD 31% dhe qeveria 18%.

Disa media shkelen heshtjen elektorale, prej 48 oresh, te percaktuar ne Kodin Elektoral, kryesisht nga pasqyrimi i konferencave per shtyp te dhena nga partite politike dhe kandidatet per denoncimin e parregullsive ne procesin zgjedhor, i cili shpesh perfshinte propagande elektorale.

KQZ, ne kuadrin e pergjegjesive shtese sipas Kodit te ri Elektoral, ngriti Bordin e Monitorimit te Mediave per te rregulluar pasqyrimin mediatik. Pavaresisht se veprimtaria e BMM u pengua ne fillim nga nje vonese ne caktimin e anetareve te saj, anetaresi tejskajshmerisht e politizuar si dhe mungesa e burimeve, hartoi raporte progresive dhe ne pergjithesi perfshiu transmetuesit TV sipas rregulloreve. Ngritja e njesive monitoruese te mediave lokale ne KQZV nuk u arrit per shkak te voneses ne organizimin e BMM si dhe mungeses se burimeve njerezore dhe financiare. Megjithate, BMM mundi te kryente disa monitorime te rastit ne nivel lokal.

### **Ankesat dhe Apelimet Parazgjedhore**

Sistemi I ankesave dhe apelimeve te percaktuara ne kodin e ri electoral pergjithsisht ka funksionuar mire kur eshte perdorur. Megjithate koncepti I mbushjes formale te ankesave nuk eshte pranuar ende gjerisht nga partite politike, kandidatet dhe administrata zgjedhor ne nivelet vendore. Ne periudhen parazgjedhore, partite politike kane shfaqur tendencen e anashkalimit te sistemit te ankimit dhe apelimit sic eshte percaktuar ne Kodin Elektoral. Si rezultat, KQZ duhej te trajtonte ceshtje qe sipas Kodit Elektoral nuk jane pergjegjesite e veta primare. Per shembull, partit politike paraqiten listen e emrave te votuesve, qe mendohej se mungonin nga lista e votuesve, shpesh pa dokumentat e duhura per evidentimin e ankesave, prane KQZ ne vend te KZPV dhe Gjykatën e rrethit. Apelimet e pakta te paraqitura ne Gjykatën e Rrethit shpesh jane paraqitur ne prag te dites se votimit, jashte afateve kohore te percaktuara ne Kodin Zgjedhor.

KQZ nuk I trajtoi ankesat dhe apelimet e adresuara ne menyren e duhur. Si rezultat, ne raste te ndryshme KQZ nuk mundi t'u permbahej afateve kohore te percaktuara ne Kodin Elektoral per te vendosur mbi apelimet dhe ankimit.

Perpara dites se zgjedhjeve, Kolegji Elektoral gjykoi rreth 20 apelime kunder vendimeve te KQZ ne nje menyre te shpejt dhe efikase, duke ruajtur parimet e procesit korrekt.

### **Pjesemarrja e Grave ne Procesin Elektoral**

Megjithese struktura ligjore per zgjedhjet siguron te drejta te barabarta per pjesemarrjen e grave, vetem 70 (3.5%) e 1,948 kandidate per kryetar bashkie, apo keshillave te komunave ishin gra.

OSBE/ODIHR, ne takimet me gra aktiviste politikane, u informua se shume drejtues te partive politike jane plotesisht kunder perfshirjes se tyre ne jeten politike. Nje numer kandidatesh femra raportuan terheqjen e kandidatures se tyre, per shkak te presionit nga selia qendrore e partive te tyre.

Grate jane perfaqesuar shume dobet edhe ne administraten zgjedhore. Edhe pse 40% e Sekretariatit te KQZ jane gra, ne shtate anetare perkatesisht te KQZ dhe BMM, nje anetare ne KQZ dhe dy anetare ne BMM jane femra. Ne ditën e zgjedhjeve, vezhguesit nderkombetar raportuan se 23% e anetareve te KQV-ve jane femra.

Grate jane te perfaqesuara me mire ne organizatat e shoqerise civile te perfshira ne zgjedhje. Nje numer organizatash kane bere fushate per rritjen e aksesit ne vendimmarrje si dhe perfshirjen me te madhe ne jeten politike, ndersa nje shoqate shqiptare per grate mori pjese ne vezhgimin e dites se zgjedhjeve.

Ne nje zhvillim pozitiv, pothuajse te gjithë kandidatet dhe partite iu referuan ceshtjeve te grave ne programet e tyre politike dhe disa organizuan veprimtari zgjedhore te fokusuar vecanerisht tek femra. Megjithate, kandidatet femra raportuan se media nuk do te mbuloje fushatat e tyre.

### **Pjesemarrja e Minoriteteve Kombetare ne Procesin Elektoral**

Grupet minoritare ne Shqiperi njihen zyrtarisht te klasifikuara ne dy kategori, kombetare dhe kulturore. Minoritetet kombetare jane greke, maqedonase, dhe malazeze. Grupet e klasifikuara si kulturore jane Rome dhe Arumune/Vllahë.

Nuk jane marre raportime direkte mbi diskriminim te ushtruar ndaj minoriteteve te njohura gjate procesit zgjedhor. Megjithate, per shkak te diskriminimit te vazhdueshem ne shoqeri, Romet hasin pengesa ne pjesemarrjen e tyre ne zgjedhje. Shume rome nuk kane dokumentet e duhura te identifikimit dhe si rrjedhim nuk rezultojne ne listat e votimit. Ka pak evidenca se partite politike kane trajtuar ceshtje qe lidhen me komunitetin e romeve.

### **Vezhguesit vendas**

Kodi i ri elektoral ka zgjeruar te drejtat e vezhguesve vendas te cileve u eshte siguruar akses ne te gjitha aspektet e procesit elektoral. Ne nje zhvillim pozitiv, nje grup prej 18 organizatash te shoqerise civile, te mbeshtetura nga Prezenca e OSBE-se ne Shqiperi organizuan nje vezhgim me te gjere se ne zgjedhjet e meparshme duke vendosur 2,200 vezhgues ne ditën e zgjedhjeve te qendrave te votimit te vizituara. Shume kane raportuar se nuk u eshte lejuar hyrja ne qendren e votimit, ose nuk u eshte dhene kopje e proces verbalit te rezultateve, duke shkelur ligjin.

### **Dita e Zgjedhjeve**

Vezhguesit e MNVZ, edhe pse ka nje atmosfere pergjithesisht te qete ne ditën e zgjedhjeve, raportuan tension ne 9% dhe presion ne 6% te qendrave te votimit qe kane vizituar. Nje varg incidentesh te dhunshme kane ndodhur ne qendrat e votimit ne Himare. Mosmarreveshjet ndermjet dy anetareve te KQZV ndaluan votimin ne Lure dhe Vau i Dejes.

Pati nje vleresim pozitiv ne 88% te qendrave te vizituara te votimit, raportime mbi procedurat kryesisht te respektuara, me perjashtim te mosaplikimit te bojës per te parandaluar votimin dy here (16%), apo te dokumentave te kerkuara te identifikimit (14%). Nje problem i vazhdueshem eshte votimi ne grup (36%). Ne krahasim me zgjedhjet e meparshme, pati nje ulje te prezences se personave te paautorizuar ne qendrat e votimit (6%), ndersa policia kryesisht iu mbajt udhezimeve te reja duke qendruar larg qendrave te votimit duke rezultuar se ka patur shume pake pretendime per nderhyrje te policise ne procesin zgjedhor. Vezhguesit e partive, apo kandidateteve ishin te pranishem ne 85% te qendrave te votimit. Nje e katerta e qendrave te votimit kishin pengesa qe kufizonin, apo ndalonin hyrjen e votuesve me aftesi te kufizuar.

Vezhguesit nderkombetare raportuan nje numer te larte rastesh ku votuesit ishin larguar nga qendrat e votimit (71%) sepse emrat e tyre nuk ishin perfshire ne listat e votuesve. Megjithese numri i personave te prekur ishte shume i vogel, shume ankesa iu bene prezente vezhguesve te MNVZ se perjashtime te tilla ishin te qellimshme. Votimi u nderpre ne nje numer qendrash votimi, sepse kutite e votimit ishin shume te vogla ne permasa per te mbajtur te gjitha fletet e votimit.

Problemet me shume serioze u vezhguan pas mbylljes se qendrave te votimit, me 37% te qendrave te votimit duke patur nje vleresim negativ te procesit te numerimit, dhe 42% gabime dhe fshirje procedurale te dukshme. Ka patur debate mbi vlefshmerine e fletave te votimit ne 45% te qendrave te votimit, duke rezultuar ne nje perqindje relativisht te larte te fleteve te pavlefshme te votimit. Megjithate, numerimi u be ne menyren me transparente (96%) dhe ka patur vetem kater raste ku nje anetar I KQV refuzoi te firmoste protokollin e rezultateve zyrtare.

Ka patur vonesa ne perpilimin statistikor te rezultateve nga KZQV, shume prej te cilave nuk kane filluar deri ne momentin e kesaj Deklarate. MNVZ do te vazhdoje te vezhgoje kete proces qe mund te zgjas per ca kohe. Deshtimi I KQZ per te rene dakort ne shpalljen e rezultateve paraprake ka lene terren te hapur qe partite politike te paraqesin pretendimet e tyre ditën pas zgjedhjeve.

*Kjo deklarate gjendet edhe ne shqip.  
Megjithate, teksti anglisht mbetet versioni i vetem zyrtar.*

---

## INFORMACIONI DHE VLERESIMET E MISIONIT

---

Ambasador Rober Barry (SHBA) shef i Misionit te Vezhgimit te Zgjedhjeve (MVZ) OSCE/ODIHR. zj. Helene Lund (Danimarke) kryeson delegacionin e vezhguesve afatshkurter te KE/KEAVR.

MNVZ nxjerr kete deklarate perpara publikimit perfundimtar te rezultateve te zgjedhjeve dhe perpara nje analize te plote mbi te dhenat e vezhguesve. OSBE/ODIHR dhe KE/KEAVR do te nxjerrin raportin e plote rreth nje muaji pas perfundimit te procesit elektoral.

Kjo deklarate eshte bazuar mbi vezhgimet nga njembedhete ekspertet zgjedhor te MVZ OSBE/ODIHR te vendosur ne Tirane si dhe tetembedhete veshgues afatgjate te vendosur ne Shkoder, Kukes, Peshkopi, Tirane, Elbasan, Durres, Korce, Vlore dhe Gjirokaster per kater jave para dites se zgjedhjeve. Deklarata perfshine gjithashtu edhe te dhenat per ditën e zgjedhjeve nga 230 vezhgues afat shkurterduke perfshire 10 nga KEAVR, te raportuara nga mbi 1000 qendra votimi nga 4,688 qendra votimi ne total ne te gjithe vendin.

Kjo deklarate paraprake dhe rezultati paraprak i monitorimit te medias per fushaten elektorale i OSBE/ODIHR gjenden ne Website e OSBE/ODIHR.

MNVZ deshiron te shprehe vleresimet per Ministrine e Puneve te Jashtme, KQZ, dhe Autoriteteve te tjera te Republikes se Shqiperise, per bashkepunimin dhe ndihmesen gjate periudhes se vezhgimit.

Per informacione te metejshme, ju lutem kontaktoni:

Ambasador Robert L. Barry, Shef i Misionit te Vezhgimit te Zgjedhjeve OSBE/ODIHR ne Tirane (Tel: +381 81 243 535) deri ne 20 Tetor;

z. Curtis Budden, Shef i Marrdhenieve me Publikun OSBE/ODIHR, ose z. Andrew Bruce, Keshilltar per Zgjedhjet, OSBE/ODIHR ne Varshave (Tel: +48 22 520 0600)

z. Gyorgy Bergou, Sekretariati KE/KEAVR, Strazburg (Tel: +33 3 88 412 804)

OSCE/ODIHR Election Observation Mission  
rr. Donika Kastrioti # 4/III  
Tirana  
Albania

Tel.: +355-4-272170/259596/259597  
Fax: +355-4-272173  
e-mail: [odihr@albaniaonline.al](mailto:odihr@albaniaonline.al)